

DETAJET: Gruaja e akuzonte për dhunë, ish-polici e vrau sapo dolën nga Gjykata. Qëlloi edhe mbi avokatin e saj, dy të plagosurit, jashtë rrezikut

May 6, 2021 13:31



Nga Arkiva

- Braçe : Saliu nuk u bë burrë sa Luiza të lejonte drejtësinë të bënte drejtësi për të birin
04.Nov
- Masat: Shqipëria mbyll përkohësisht kufirin me Kosovën
13.Mar
- Drejtorit Tufa i "është dërguar një kërcënim i ri me vdekje"
29.Sep

Ish-polici Koço Buzo ka qëlluar më kallashnikov jo vetëm gruan e tij që e la të vdekur në vend por edhe avokatin e gruas së tij dhe një kalimtar të rastit.

7 plumba kane dale nga kallashi i tij. Personat po dilnin nga seanca gjyqësore pasi autori akuzohej për dhunë në familje

Nderkohe policia e Elbasanit ka dhënë detaje në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur sot në mesditë në Gjykatën e qytetit.

‘Rreth orës 12:15, në afërsi të Gjykatës, shtetasi K. B., 58 vjeç, ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të bashkëshortes së tij, shtetases L. B., 54 vjeçe, e cila si pasojë e plagëve të marra ka ndërruar jetë gjatë rrugës për në spital.

Si pasojë e të shtënave është plagosur në këmbë edhe një kalimtar i rastit, shtetasi G. T., i cili ndodhet në spital, jashtë rrezikut për jetën.

Gjithashtu është paraqitur në spital, i dëmtuar në dorë, edhe shtetasi A. K., i cili pasi ka marrë ndihmën mjekësore është larguar për në banesë.

Ndërhyrja në kohë e shërbimeve të Policisë ka bërë të mundur kapjen dhe prangosjen e autorit, sekuestrimin e armës së zjarrit tip kallashnikov dhe të një arme të ftohtë thikë.

Në vendngjarje ndodhet grupi hetimor dhe nën drejtimin e Prokurorisë vijon puna për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes”, thuhet në njoftimin e policisë.

o./dita



May 6, 2021 13:31

Media Sociale
Ndaje me miqtë

PrintojeNise me e-mail

4 KOMENTE

Komento

- Arben

Shyqyr qe filloi plotesimi i kushteve per integrim

Reply to this comment
- mirel

Nderkohe si pasoje, si pasoje dhe nderkohe
Nderkohe eshte paraqitur ne spital
Ne spital eshte paraqitur dhe kalimtari, si pasoje

Reply to this comment
- Juli

Jam i keqardhur qe komentuesi i mesiper Mirel ka qasje te tille ironike ne lidhje me artikullin e mesiperm, Shumica e lexuesve jane te dakordesuar me stilin e shkrimit te artikujve.

Reply to this comment
- Lili

Cfare pdikopate kemi ne polici! Tmerr i vertete!
Si shoqeri kemi hala shume pune per te bere qe te dallim nga keso mendje arkaike! E institucionet kane shume pune per te bere per sigurine e jeten e grave te dhunuara!

Reply to this comment

KOMENTO

Shiko komentet

Your e-mail address will not be published.
Required fields are marked *

Komenti *

Mesazhi juaj..

Nickname *

Nickname..

E-mail *

E-mail..

Website

Website..

Posto komentin


Media Sociale
Ndaje me miqtë

PrintojeNise me e-mail

Aleanca për Media Etike

Artikull joetik?

raporto këtu



f62.7KNDJEKËS

12.3KNDJEKËS

YouTube13.4KNDJEKËS

